



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2020:160988

Datë: 04.07.2022

Numri i dokumentit: 03195841

**C.nr.1009/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË VITI**, Departamenti i Përgjithshëm - divizioni civil, gjyqtari Alush Sinani me zyrtaren ligjore Qëndresa Sejdiu, në çështjen juridike të paditëses NN nga Vitia, të cilën e përfaqëson me autorizim Minir Arifi avokat nga Vitia, kundër të paditurës Komuna e Vitisë, të cilën e përfaqëson i autorizuari Ekrem Shabani, Zyrtar i Lartë në DKA-së në Viti, me objekt kontesti, kompensimi i pages jubilarë dhe kompensimi i shpenzimeve të ushqimit, vlera e kontesitit XXX €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik të mbajtur me datë 30.06.2022, merr kete:

## A K T G J Y K I M

**I. Apropohet** si e bazuar me ligj, kërkesëpadia e paditëses Ylberë Lutfiu nga Vitia.

**II. Detyrohet** e paditura Komuna e Vitisë, që paditësit të ia paguajë në emër të shpërblimit jubilar, shumën e të hollave në lartësi prej 210.50 €, si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, shumën prej 914.00 €, respektivisht shumën e përgjithshme të të hollave në lartësi prej 1,124.50 €, €, me kamatë ligjore prej 8% nga data 18.11.2020 (data e paraqitjes së padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditësh pas ditës së plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

**III Detyrohet** e paditura Komuna e Vitisë që paditësit, në emër të shpenzimeve të procedurës t'ia kompensoj shumën e të hollave prej XXX € euro, në afat prej 7 ditë, nga data e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

**IV. Detyrohet** paditësja që konform vlerës së shtuar të kontestit të paguaj takson 10.00 € shtesë për padi në afat prej 3 ditësh edhe nje kopje të fatures se pageses te ja sjellë gjykatës nën pasojat ligjore te mos veprimit.

## A s y e t i m

Paditësja NN nga Vitia, në këtë gjykatë ka parashtruar padi me datën 18.11.2020 kundër të paditurës, Komuna e Vitisë me objekt kontesti, kompensimi i pagës jubilarë, shpenzimeve të ushqimit si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, duke iu referuar dispozitave të nenit 35 paragraf 8 dhe nenit 35 paragraf 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, ka kërkuar nga gjykata që të detyroj të paditurën që paditësen ta kompensoj në emër të

kompensimit të pages jubilarë dhe shpenzimeve të ushqimit, gjithashtu ka kërkuar edhe kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore, të gjitha në afat prej 7 ditësh pas ditës së plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

E paditura përmes përgjigjes në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, me arsyetimin se paditësja kërkesëpadinë e saj e bazon në Kontratën Kolektive të Arsimit të Kosovës (në vijim: KKAK), të datës 18.04.2017, të miratuar dhe nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë (në vijim: MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (në vijim: SBASHK), respektivisht në dispozitat e nenit 35 pika 7 dhe 8 të kësaj kontrate, e sipas të paditurës kjo kontratë nuk prodhon efekt juridik dhe ka kërkuar nga gjykata që këtë padi ta refuzoj si të pabazuar dhe joligjore, për shkakun se DKA-ja nuk është përgjegjëse që nuk janë siguruar mjetet për këtë destinim nga ana e Qeverisë dhe Ministrive përkatëse.

Paditësja, përmes përfaqësuesit të saj Minir Arifi av, nga Vitia, me dt. 14.04.2021, në këtë gjykatë ka dorëzuar parashtresë për precizimin dhe plotësimin e padisë dhe kërkesëpadisë, ku nga gjykata ka kërkuar që e paditura, të obligohet që në emër të shpërblimit jubilar për mbi 10 vite të përvojës së punës, t'i paguajë vlerën prej 50 % të një page bazë, pra shumë prej XX €, si dhe në emër të shpenzimeve të ushqimit për 457 ditë pune nga 2€, pra shumë prej 914.00 €, e që në total shuma e përgjithshme i bie XXX € në afat prej 7 ditësh pas ditës së plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë 18.11.2020.

Gjykata, në lidhje me këtë çështje më dt. 30.06.2022, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor, ku për shkak të pandërlikueshmërisë së çështjes, gjykata në harmoni me nenin 401 të LPK-së, nuk ka konvokuar seancë përgatitore, por ka vazhduar me shqyrtimin kryesor të çështjes.

### **Kërkesat e Palëve:**

Përfaqësuesi i paditëses Minir Arifi avokat nga Vitia gjatë seancës gjyqësore dhe shpjegimeve përfundimtare, ka deklaruar se se mbetet në tersi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së precizuar me parashtresën e dorëzuar në gjykatë me datë 14.04.2021, ku nga gjykata ka kërkuar që e paditura në emër të shpërblimit jubilar për mbi 10 vite të përvojës së punës ka kërkuar nga gjykata që të obligojë të paditurën të paguajë 50 % të një page bazë, e që në rastin konkret të paguhet shuma prej XX €, si dhe në emër të shpenzimeve të ushqimit duke filluar nga data 18.04.2017 e deri me datën 21.01.2021, edhe atë për 457 ditë pune duke llogaritur nga dy euro në ditë të ja paguaj shumën prej XXX euro €, e që në total shuma e përgjithshme i bie 1XXX euro si dhe pagesën e shpenzimeve procedurale në vlerë prej xx.00€, pra për taksë gjyqësore shumë prej 3xx00€, për përpilimin e padisë shumë prej xx00€ dhe për përfaqësim në një seancë shumë prej xxx00€.

Përfaqësuesi i të paditurës, si në shqyrtimin kryesor të dt. 30.06.2022 edhe në shpjegimet përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë përgjigjes në padi duke kërkuar nga Gjykata që këtë padi ta refuzoj si të pabazuar në ligj. Për faktin se DKA nuk është përgjegjëse për mos pagesën e ktyre beneficioneve për mësimdhënësit dhe se kjo përgjegjësi është e Qeverisë së Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministrive përkatëse.

### **Provat e administruara;**

Gjykata për të vepruar drejtë dhe për t'i vlerësuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse në këtë çështje kontestimore, ka administruar dhe vlerësuar këto prova materiale: Kërkesen drejtuar DKA-së, me numer 05-320/04-xxx, dates 11.11.2020, Përgjegjen ne kërkesë me numer të njejtë, dates 13.11.2020, Vërtetimi numer xxx/2021 i dates 03.02.2021, lëshuar nga SHFMU „D..t e V...” në Viti, permes të cilit vërtetohen ditet e punes, Listen e pagave me shenjen EM00..., në emer të paditses, me te cilen vertetohet pervoja e punes se paditeses

### **Gjendja faktike e vërtetuar:**

Gjykata analizoi secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku si në kuptim të nenit 8, të LPK-së dhe vërtetoi se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar me ligj, ashtu që vendosi si në pikën e parë të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, duke i' a aprovuar kërkesën e paditëses sa i përket shpërblimit jubilar duke u bazuar në përvojen e punës bazuar në nenin 35, paragrafi 8, ndersa bazuar në nenin 35, paragrafi 7 i Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë / *Kontrata nr. 24 e dt. 18.04.2017/* ka aprovuar kërkesën e paditëses sa i përket kompenzimit të ushqimit, ngase në nenin përkatës në mënyrë shprehimore është përcaktuar se *„të punësuarve,u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompenzimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është dy /2/ € për të punësuarit që kanë mardhënien e punës primare në institucionet arsimore.*

Pas vlerësimit të provave të administruara, në kuptim të dispozitës së nenit 8 të LPK-së, duke vlerësuar secilin veç veç, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike sepse:

Nga Kërkesa nr.05-320/04-xxx, dates 11.11.2020, gjykata vërtetoi se paditësja i është drejtuar të paditurës, duke i kërkuar shpërblimin jubilar si dhe shpenzimet e ushqimit gjatë ditëve të punës.

Nga Lista e Pagës me nr. EM0...0, ne emër të paditsit, gjykata ka vërtetuar se paditësi ka një përvojë të punës në institucione arsimore prej mbi 10 vite si mësimdhënës në shkollën e lartëcekur, kurse paga jubilarë në vlerë prej 50 % nga paga bazë është në shumë prej xx.50 €.

Nga Vërtetimi me numer xx/2021 i dates 03.02.2021, lëshuar nga SHFMU „D.. e V...” Viti, gjykata ka vërtetuar se paditësi, ka gjithsej 457 ditë të punës, ku për vitin shkollor 2016/17 paditësja ka 40 ditë të punës, për vitin shkollor 2017/18, ka 175 ditë të punës, për vitin shkollor 2018/19, ka 56 ditë të punës, për vitin shkollor 2019/20, paditësja ka 121 ditë të punës dhe per vitin shkollor 2020/21 paditësja ka 65 ditë pune, për të cilat llogaritet shuma prej 2 dy euro në ditë, e që shuma totale për kompenzimin e shujtes është xxx euro

### **Vendimi i gjykatës**

Nga gjendja faktike e shpjeguar si më lart dhe bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit të dt. 18.04.2017 dhe e dt. 22.01.2021,

Gjykata vërteton se kërkesa e paditësit për shpërblimin jubilar, ka bazë në nenin 35, paragrafi 8, nën-paragrafi 8.2, ku paditësja për 10 vite të përvojës së punës, ka të drejtë të kompensohet në vlerë prej 50% të një page bazë, e që në rastin konkret i bie që për përvojen e punës prej 10 viteve, ka të drejtë në shpërblim prej xxx50 € nga e paditura, gjithashtu në nenin 35, paragrafi 8, nën-paragrafi 8.5 theksohet se pagesën për shpërblim jubilar, duhet ta realizojë

punëdhënësi kur plotësohen kushtet për një gjë të tillë, e që në rastin konkret punëdhënësi është Komuna e Vitisë.

Gjykata vërteton se kërkesa e paditësit për shpërblimin për shujta ka bazë në nenin 35, paragrafi 7 i Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë / Kontrata nr. 24 e dt. 18.04.2017/ ngase në nenin përkatës në mënyrë shprehimore është përcaktuar se „të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompenzimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është dy /2/ € për të punësuarit që kanë mardhënien e punës primare në institucionet arsimore e që në rastin konkret paditësi ka gjithsej 457 ditë pune dhe i takon shuma prej xxx euro duke i llogaritur 2 euro në ditë

*Andaj, duke u bazuar në një gjendje të tillë faktike të pakontestuar e konform nenit 35 paragrafi 8 dhe nenit 35 paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë/ Kontrata nr. 24 e dt. 18.04.2017/ gjykata e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, si të bazuar me ligj, ngase në mardhëniet e detyrimeve debitori dhe kreditori kanë detyrime që me ndërgjegjëje dhe pavarësisht të përmbushin detyrimet reciproke e në rast të mospërmbushjes lindë e drejta e kreditorit që të kërkojë nga debitori, pas përmbushjes e detyrimi edhe në mënyrë eventuale që pëson kreditori për shkak të vonësës. Një detyrim i tillë shprehimisht është përcaktuar në nenin 245 të LMD, /Ligji nr. 04/L-077, datë 10 maj 2012 /, citat; „Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë atë me ndërgjegjëje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij. 2. Kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonohet me përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak.*

Pretendimet e përfaqësuesit të palës së paditur se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, nuk është e palë si dhe faktin se të njëjtit nuk janë palë nënshkruese të kësaj Kontrate Kolektive të Arsimit dhe për të njëjtin si Drejtori Komunal e Arsimit, nuk paraqet ndonjë detyrim, duke konsideruar se nuk kanë legjitimitet real pasiv në këtë çështje juridike kontestimore, si dhe pretendimin se kërkesëpadia e paditësit për kompenzimin e ushqimit dhe udhëtimit për ditët në punë është në tërësi e pa bazuar dhe e njëjta të refuzohet si e tillë, për gjykatën këto pretendime ishin të pa bazuara, për faktin se me nenin 2, të Kontratës Kolektive të lartëcekur, të gjitha Drejtorit Komunal të Arsimit, në Kosovë, janë të obliguara ta zbatojnë Kontratën Kolektive të lartëcekur dhe me kohë të planifikojnë mjete buxhetore për këto raste, poashtu duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 4, pika 2, të kësaj kontrate Kolektive të lartëcekur, paditësi, me pozitë të punës mësimdhëns, hynë në kuadër të pëfituesve të të drejtave që rrjedhin nga kjo Kontratë Kolektive e Arsimit. Andaj, përgjegjësia për kompenzim të pages jubilarë është te e paditura, respektivisht të DKA-së, në Viti.

Gjykata konstaton se paditësi ka shtjerur mjetet e brendshme juridike duke iu drejtuar me kërkesë të paditurës për kompenzimin e kërkesave nga marrëdhënia e punës, por që e paditura në përgjigje në kërkesë dhe gjatë seancës gjyqësore, i ka refuzuar me arsyetim se nuk kanë mjete buxhetore për këtë destinim.

Lidhur me kërkesën për kamatë ligjore, Gjykata vendosi duke u bazuar në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve NR.04/L-077, i cili detyrim rrjedhë nga neni 382, i cili shprehimisht përcakton se “Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debitor,

*përpos borxhit kryesor, edhe kamatën, 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.*

### **Shpenzimet e procedurës**

Gjykata, vendosi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore duke u mbështetur në nenin 452, paragrafi 2, të LPK-së, ku parashihet se *“Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve”*, si dhe në bazë të tarifës së zbatuar të Odës së Avokatëve të Kosovës. Andaj, në rastin konkret, gjykata konsideron se, fakti që paditësi pati pjesërisht sukses në procedurë, është i pa ndikim në kompenzimin e shpenzimeve të domosdoshme dhe e detyrojë të paditurën, që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej xxx.00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej xxx euro, në emër të taksës gjyqësore për paraqitjen e padisë shumë prej xxx euro dhe për përfaqësim në seancën kryesore shumë prej xxx euro.

Duke u bazuar në të lartëcekurat, si dhe në nenin 143, të Ligjit të Procedurës Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2020:160988, 30.06.2022  
C.nr.1009/2020**

G j y q t a r i  
Alush Sinani

**Udhëzim mbi Mjetin Juridik:** kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit, përmes kësaj Gjykate.